



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3-10/2021 regjistri (JD)
Datë. 15.02.2022

Nr. 4 i vendimit
Datë 03.10.2022

VENDIM
I KOLEGJIT TË SHQYRTIMIT PARAPRAK

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Gjyqtar
Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Natasha Mulaj	Gjyqtare

– mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, më datë 03.10.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 3-10/2021, datë 15.02.2022, që i përket:

KËRKUES: Hasan Roqi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese:
Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Elsa Toska.

OBJEKTI:

1. Saktësimi i të metave të vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
2. Plotësimi i vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
3. Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
4. Kthimi nga Gjykata Kushtetuese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit i vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, për shkak të detyrueshmërisë të respektimit të kompetencës dhe juridiksionit në çështjen e Juridiksionit Disiplinor nr. 10, datë 02 nëntor 2021, të diktuar nga dispozita e nenit 86, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pamarrë në konsideratë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

5. Publikimi i kësaj kërkesë pranë vendimit nr. 3, datë 25 janar 2021, në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese, KPA, për publikun.
6. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.
7. Ruajtja e jetës së kërkuesit dhe e familjarëve të tij: Hasan Roqi, L. R., S. R., K. R., nga banda e strukturuar kriminale që shkelin Kushtetutën e RSh-së, KEDNj-në dhe ligjin 8577/2000.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 15; neni 17, pikat 1 dhe 2; neni 18, pikat 1, 2 dhe 3; neni 25; neni 37; neni 41, pikat 1 dhe 2; neni 44; neni 122, pikat 1, 2 dhe 3; neni 126; neni 128, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c”; neni 131, pika 1, shkronja “f”; neni 132, pikat 1 dhe 2; neni 134, pika 1, shkronja “i”; neni 137; neni 179, pika 7.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: nenet 3; 6.1; 8.1; 13; 14; 41; Protokolli 1, neni 1; Protokolli 16, neni 1.

Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: neni 1, pikat 1 dhe 2; neni 10, pikat 6, 9 dhe 13; neni 10/a; neni 10/b, pika 1, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”; neni 10/c, pika a; neni 10/ç, pika 3; neni 16; neni 25, pika 1; neni 26, pikat 1, 2 dhe 3 (për vendimin 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese); neni 31/c, pikat 1 (fjalë e fundit) dhe 2; neni 34, shkronja “a”; neni 38, pika 6; neni 42, pikat 1, 2 dhe 3; neni 44/b, pikat 1 dhe 2; neni 45, pikat 1 dhe 2; neni 48, pika 1; neni 49, pika 3, shkronja “e”, pika 4; neni 50, pika 4; neni 51, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”; neni 54, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 55; neni 71, pikat 1, 2 dhe 3; 71/a, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”; neni 71/b, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 72, pika 7; neni 76, pikat 1, 2 dhe 3; neni 80, pika 1; 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 86, pika 1.

Kodi i Procedurës Civile: nenet 312, 313, 314 dhe 451/a.

Kodi Civil: nenet 608, 609, 610, 625 dhe 640.

Ligji 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative: neni 4, pikat 1 dhe 2; neni 5; neni 11; neni 13; neni 15; neni 24, pika 1; neni 25.

Kodi i Procedurës Penale: neni 281.

Kodi Penal: neni 300.

Kolegji i shqyrtimit paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtarin relator Sokol Çomo, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) është administruar kërkesa e paraqitur nga z. Hasan Roqi me nr. {***} prot., datë 15.02.2022, me objekt dhe bazë ligjore si ajo e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.
2. Kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa të tjera në Kolegji që i përkasin juridiksionit disiplinor, për të cilat, nga kolegjet përkatëse të shqyrtimit paraprak, janë dhënë vendimet: nr. 1/2022, datë 17.01.2022; nr. 2/2022, datë 24.01.2022; nr. 3/2022, datë 25.01.2022 dhe nr. 3/2021, datë 20.12.2021, me të cilat është vendosur “Moskalimi i çështjes në seancë plenare”.
3. Kolegji i shqyrtimit paraprak, në vendimin nr. 3, datë 25.01.2022, që i përket çështjes së juridiksionit disiplinor (JD) nr. 10/2021, datë 01.11.2021, ka çmuar se të gjitha kërkimet e paraqitura nga kërkuesi nuk janë në kompetencën dhe juridiksionin e Kolegjit dhe, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577, datë 10.02.2000”) ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe përcjelljen e kërkesës së kërkuesit Hasan Roqi Gjykatës Kushtetuese.
4. Me kërkesën nr. {***} prot., datë 15.02.2022, z. Hasan Roqi ka kërkuar *saktësimin, plotësimin, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 3, datë 25.01.2022, të Kolegjit, si dhe kthimin nga Gjykata Kushtetuese në Kolegji të vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, publikimin e kësaj kërkesë pranë vendimit nr. 3, datë 25 janar 2022, në faqen zyrtare të Kolegjit, shqyrtimin e çështjes në seancë plenare në Kolegji, ruajtjen e jetës së kërkuesit dhe familjarëve të tij nga banda e strukturuar kriminale që shkelin Kushtetutën e RSh-së, KEDNj-në dhe ligjin nr. 8577/2000.*

II. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

5. Kolegji vlerëson se pas shpalljes së vendimit nr. 3, datë 25.01.2022, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak, ky vendim nuk mund të anulohet ose të ndryshohet, por në mënyrë përjashtimore, ai mund të saktësohet ose plotësohet kur ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto kushte, në këtë vendim do të trajtohen vetëm kërkimet e kërkuesit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 3, datë 25.01.2022 dhe nuk do të trajtohen kërkimet që kanë të bëjnë me anulimin ose ndryshimin e vendimit të sipërcituar.
6. *Lidhur me pretendimin e kërkuesit për pasqyrimin e plotë në rubrikën I, “Rrethanat e çështjes”, të defekteve dhe mangësive të gjykimit në Gjykatën Kushtetuese, Kolegji vlerëson se në rubrikën “Rrethanat e çështjes”, në faqen 3 të vendimit nr. 03, datë 25.01.2022, janë cituar në mënyrë të*

përmbledhur vendimet e Gjykatës Kushtetuese¹ për të cilat kërkuesi pretendon në objektin e kërkesës se janë kryer shkelje disiplinore nga ana e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kërkon shpalljen antikushtetuese të këtyre vendimeve. Gjithashtu në paragrafët 3 dhe 4 të këtij vendimi, janë cituar kërkesat e tij drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Sa i përket pretendimit të kërkuesit për paraqitjen sa më të detajuar të rrethanave të çështjes së tij në Gjykatën Kushtetuese, në kuadër të transparencës së publikut, Kolegji vëren se vendimet për të cilat kërkuesi pretendon se janë kryer shkeljet nga ana e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht vendimet nr. 86, datë 22.06.2021, nr. 86/1, datë 28.09.2021 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimi nr. 111, datë 28.09.2021, me objekt “Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 86, datë 22.06.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, janë vendime të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese me akses të plotë për publikun.

7. Për sa i përket pretendimit: Në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuesit”, paragrafi 6.3, gjykata ka vendosur në mënyrë të gabuar fjalinë e këtij paragrafi, të cilën duhet ta heqë dhe ta zëvendësojë me fjalinë e duhur e të drejtë, të dhënë nga kërkuesi në objektin e parë të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, datë 25 mars 2021 [...], pasi kërkuesi pretendon se nuk ka kërkuar shfuqizimin e disa vendimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Kolegji vëren se:
 - Nga leximi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese² të dorëzuara nga vetë kërkuesi në Kolegji, konkretisht të vendimit nr. 111, datë 28.09.2021, rezultoi se në paragrafin e parë tij, “Rrethanat e çështjes”, citohet: [...] Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 09.04.2021, me kërkesë (regjistruar fillimisht si e paplotë në datën 26.03.2021), me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve datë 29.04.2020 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për kallëzimin penal nr. {***} prot., datë 14.04.2020; nr. {***}, datë 12.06.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. {***}, datë 16.09.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar [...]”. Për rrjedhojë, në vendimin nr. 3/2022, datë 25.01.2022, të Kolegjit, objekti i kërkesës së z. Hasan Roqi është pasqyruar sipas objektit të treguar në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese.
 - Ndërsa lidhur me pretendimin për përdorimin e pasaktë të termit “ndihmë juridike parësore” në paragrafin 6.3 të rubrikës II, “Pretendimet e kërkuesit”, Kolegji vëren se terminologjia e përdorur nga kërkuesi është “ndihmë juridike dytësore”, por pavarësisht kësaj, Kolegji vlerëson se ky është një element i parëndësishëm në trajtimin dhe argumentimin e vendimit.
8. Kërkuesi pretendon gjithashtu se në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuesit”, paragrafi 6.7 i vendimit nr. 3/2022 të Kolegjit, është vendosur gabim “shkronja “ç” e nenit 10/c, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, prandaj duhet të korrigjohet duke vendosur në vend të saj shkronjën “c”. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak vlerëson se baza ligjore në këtë paragraf është vendosur në referim të bazës ligjore të përcaktuar nga vetë kërkuesi në kërkesën e tij të depozituar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 21.10.2021, konkretisht në faqen 7, pika 19 e kërkesës.
9. Në përfundim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa e kërkuesit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 03/2022, datë 25.01.2022, të Kolegjit, nuk bazohet në ekzistencën e ndonjë gabimi në shkrim ose ndonjë pasaktësie të dukshme, por bazohet në pretendime dhe

¹ Shih paragrafin nr. 2 të vendimit të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak nr. 03, datë 25.01.2022.

² Referoju vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 86, datë 22.06.2021 dhe nr. 111, datë 28.09.2021.

kërkime për të ndryshuar thelbin e vendimmarrjes së Kolegjit, në kundërshtim me nenet 75 dhe 76, pika 1, dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë ajo është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenet 31 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Hasan Roqi.

Tiranë, më 03.10. 2022

ANËTAR
Sokol ÇOMO
nënshkrimi

ANËTARE
Natasha MULAJ
nënshkrimi

ANËTARE
Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi